



JETESA E PAVARUR DHE PËRFSHIRJA NË KOMUNITET

Ky dokument u realizua me fonde të Qeverisë Suedeze nëpërmjet bashkëpunimit me Civil Rights Defenders.

I. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka hyrë në fuqi më 3 Maj të vitit 2008. KDPAK nuk sjell të drejta të reja për personat me aftësi të kufizuara, por më tepër kufizohet në dhënien e udhëzimeve dhe parimeve mbi bazën e të cilave duhet të realizohen të drejtat ekzistuese në mënyrë specifike për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Edhe pse kjo konventë thekson se nuk ka sjellë të drejta të reja, ajo përmend disa parime si aksesibiliteti apo jetesa e pavarur, të cilat interpretohen nga disa si parime e nga disa të tjerë si të drejta. KDPAK është instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar, i cili përmend dhe rregullon në mënyrë specifike të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet.

Siç njihet botërisht segregimi apo izolimi i personave me aftësi të kufizuara është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe me të drejtat e tyre. Megjithatë, pavarësisht kësaj shumë pak veprime janë ndërmarrë në drejtim të krijimit, apo zhvillimit të alternativave të tjera të ndryshme nga alternativat e institucionalizimit, alternativa të cilat vazhdojnë të përdoren gjerësisht akoma në shumë vende.¹

Përkujdesi për personat me aftësi të kufizuara mendore ka pësuar ndryshime të mëdha në dy shekujt e fundit. Në shekullin e 19-të u ndërtuan institucione të mëdha në vendet e industrializuara për pacientët me probleme mendore. Kushtet në këto institucione u përkeqësuan në shekullin e 20-të dhe në vitet '50 filloi procesi i deinstitutionalizimit. Nga ajo kohë janë krijuar një sërë shërbimesh në komunitet për të siguruar forma alternative të përkujdesit.²Duhet theksuar që jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet nuk është vetëm një çështje e deinstitutionalizimit. Nivelet

¹ Creating Successful Campaigns for Community Living: Krijimi i fushatave të suksesshme për jetesën e pavarur. Manual advokimi për organizatat dhe ofruesit e shërbimeve, ECCL, version i rishikuar 2011.

http://community-living.info/ep-content/uploads/2014/02/Advocacy_manual.pdf

² Deinstitutionalization and reinstitutionalization: major changes in the provision of mental healthcare: Deinstitutionalizimi dhe riinstitutionalizimi: ndryshime madhore në shërbimet shëndetësore të shëndetit mendor, Éalid Fakhouri, Stefan Priebe, 2007.

<http://ebspace.qmul.ac.uk/spriebe/publications/pub%20by%20year/2007/2007%20-%20Deinstitutionalisation%20and%20reinstitutionalisation%20-%20major%20changes%20in%20the%20provision%20of%20mental%20healthcare%20Psychiatry%206.%20313-316.pdf>

<http://ebspace.qmul.ac.uk/spriebe/publications/pub%20by%20year/2007/2007%20-%20Deinstitutionalisation%20and%20reinstitutionalisation%20-%20major%20changes%20in%20the%20provision%20of%20mental%20healthcare%20Psychiatry%206.%20313-316.pdf>

e larta të institucionalizimit lidhen ngushtë me mungesën e shërbimeve në komunitet. Nga ana tjetër, mungesa e shërbimeve në komunitet lë pa zgjedhje personat me aftësi të kufizuara, e si pasojë ata vazhdojnë të jetojnë, apo “zgjedhin” të jetojnë në institucione. Është e rëndësishme që procesi i deinstitutionalizimit të zhvillohet paralelisht me ngritjen e shërbimeve në komunitet. Në lidhje me këtë mund të theksohet dhe një shqetësim i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i ngritur në konkluzionet përfundimtare,³ bazuar mbi raportin e dorëzuar nga shteti i Spanjës. Ky shqetësim ka të bëjë pikërisht me mungesën e burimeve dhe shërbimeve për të mundësuar jetesën e pavarur sidomos në zonat rurale, pasi personat me aftësi të kufizuara në kushtet e këtyre mungesave, nuk kanë lirinë e zgjedhjes dhe janë të detyruar të jetojnë në institucione rezidenciale, pasi këto janë zgjedhja e vetme.

Personat me aftësi të kufizuara në Europë përmendin përveç institucionalizimit edhe disa barierra të tjera, të cilat ndikojnë negativisht në realizimin e jetesës së pavarur, apo përfshirjes së tyre në komunitet. Kështu, disa nga këto barierra janë; mungesa e shërbimeve në komunitet, mungesa e buxheteve, mungesa e aksesit, mungesa e kapacitetit ligjor, mungesa e punësimit në tregun e hapur të punës, i cili vjen si pasojë e një arsimi special shpeshherë, gjë që ndikon më vonë negativisht në përfshirjen në tregun e hapur të punës, në të drejtën e votës dhe në jetën politike në përgjithësi.⁴

Sikurse u theksua dhe pak më lart, jetesa e pavarur përshkruhet si parim dhe njëkohësisht si një lëvizje e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara për vetëvendosje, mundësi të barabarta dhe respekt. Jetesa e pavarur nuk ka të bëjë me të jetuarit në izolim apo të jetuarit pa ndihmën e askujt.⁵

“Jetesë e pavarur nuk do të thotë se ne duam të bëjmë çdo gjë vetë dhe se nuk kemi nevojë për njeri, apo që duam të jetojmë në izolim. Jetesë e pavarur do të thotë se ne kërkojmë të kemi të njëjtat zgjedhje dhe të njëjtin kontroll mbi jetën tonë të përditshme si personat pa aftësi të kufizuara, fqinjët dhe miqtë tanë. Ne duam të rritemi në familjet tona, të shkojmë në shkollat e lagjes, të përdorim të njëjtin autobus si fqinjët tanë, të kemi një punë në përputhje me arsimin dhe aftësitë tona, të krijojmë familjet tona. Ashtu si të gjithë të tjerët, ne duhet të drejtojmë jetët tona, të mendojmë dhe të flasim për veten tonë. Ne jemi ekspertët më të mirë për nevojat tona, ne duhet të tregojmë zgjidhjet që ne duam, duhet të jemi në krye të drejtimit të jetës tonë, ashtu si gjithë të tjerët. Për këtë qëllim ne duhet të mbështetemi dhe të mësojmë nga njëri-tjetri, të organizohemi dhe të punojmë për ndryshimet politike që çojnë në mbrojtjen e të drejtave tona.”⁶

Neni 19, Jetesa e pavarur Konventa për të Drejtat e Personave me aftësi të Kufizuara

Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet janë disa nga të drejtat themelore të njeriut, të cilat konkretizohen më së miri në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në nenin 19 të saj.

³ Concluding observations of the Committee on the Rights of Persons with Disabilities, Spain: Konkluzione të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për Spanjën, 19–23 Shtator

2011. http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD%2fC%2fESP%2fCO%2f1&Lang=en

⁴ Choice and control: the right to independent living: Zgjedhja dhe kontrolli: E drejta për jetesë të pavarur, European Union Agency for Fundamental Rights (FRA), 2012. http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/2129-FRA-2012-choice-and-control_EN.pdf

⁵ A Handbook on the Human Rights of Persons with Disabilities Marianne Schulze Understanding The UN Convention On The Rights Of Persons with Disabilities: Udhëzues për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; Të kuptuarit e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Marianne Schulze, Handicap International 2010. http://ëëë.hiproëeb.org/uploads/tx_hidrtdocs/HICRPDManual2010.pdf

⁶ Independent Living Institute (ILI) <http://ëëë.independentliving.org/>

Në hapjen e këtij neni, njihet e drejta e barabartë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara, pa bërë ndonjë klasifikim të aftësive të kufizuara në bazë të llojit apo rëndesës së tyre. Kërkohej nga shtetet që të merren masat e duhura dhe efektive që t'iu mundësojnë personave me aftësi të kufizuara gëzimin e kësaj të drejte, përfshirjen në komunitet. Kuptimi i efektivitetit të masave mund të jetë subjektiv. Kështu për shembull, transferimi i personave nga institucione të mëdha në formate të tjera, ku ka shumë më pak njerëz, nuk do të thotë që masat janë të përshtatshme dhe efektive, pasi veçoritë e institucioneve të mëdha mund të jenë të dubluara edhe në formate më të vogla. Duhet theksuar që në hapjen e këtij neni, pavarësisht titullit, përmendet vetëm koncepti i përfshirjes në komunitet dhe jo jetesa e pavarur. Në të vërtetë, përfshirja në komunitet shihet si një aspekt jetësor për pavarësinë edhe mbështetjen e tyre.⁷

Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet është e lidhur ngushtë me të drejta të tjera të tilla si; mosdiskriminimi, mosçenimi i integritetit fizik dhe mendor, liria, liria nga trajtimi çnjerëzor ose degradues, autonomia, kapaciteti ligjor, e drejta e privatësisë dhe jetës familjare dhe liria e lëvizjes. Megjithatë jetesa në komunitet është më shumë një shumë e këtyre të drejtave së bashku. Jetesa në komunitet është gjithashtu e lidhur me shërbimet shëndetësore, arsimin, skemat e mbështetjes sociale, tregun e punës dhe me aksesueshmërinë në këto shërbime e megjithatë, ajo nuk është vetëm një çështje aksesueshmërie.⁸

Në pikën a) të nenit 19 ritheksohet e drejta për të zgjedhur vendbanimin dhe me kë të jetojnë duke u siguruar (në pikën b) që ata duhet të kenë akses në një game të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, në rezidenca, shërbime në komunitet dhe asistencë personale. Asistenca personale këtu është një nga format më të rëndësishme për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të marrin vendimet në jetën e përditshme duke ruajtur kapacitetin ligjor, por edhe duke ruajtur jetesën e pavarur. Kjo është përforcuar nga një hulumtim i vitit 2012⁹, i cili ka arritur në përfundimin që "asistentët personalë të zgjedhur lirisht nga vetë personi me aftësi të kufizuara mendore nxisin autonominë dhe përfshirjen duke ndihmuar në zhvillimin e aftësive të përditshme të jetesës, nxisin pjesëmarrjen në komunitet dhe në jetën kulturore, menaxhimin e çështjeve financiare dhe rritjen e aksesit në mallra dhe shërbime."

E rëndësishme gjatë leximit të këtij neni është vendosja e theksit tek mundësitë dhe zgjedhjet e barabarta me të tjerët, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara mos të jenë të detyruar të jetojnë në një format të caktuar (Pika a), neni 19).

Një përmbledhje e pikave kyçe të këtij neni është ekzistenca e zgjedhjeve dhe mundësive të barabarta për të jetuar në komunitet (pika a). Kjo realizohet përmes njohjes dhe ofrimit të shërbimeve të duhura dhe të nevojshme për të realizuar zgjedhjet në kushte të barabarta me të tjerët (pika b) dhe njëkohësisht përmes ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në kuadër të shërbimeve të përgjithshme që ofrohen për të gjithë popullatën. Në lidhje me këtë të fundit, pika c) kërkon zbatimin e parimit të qasjes së dyfishtë, përmes nënvizimit, që shërbimet dhe objektet komunitare të cilat janë të aksesueshme për të gjithë popullatën, duhet të jenë të aksesueshme edhe

⁷ Getting a Life – Living Independently and Being Included in the Community A Legal Study of the Current Use and Future Potential of the EU Structural Funds to Contribute to the Achievement of Article 19 of the United Nations Convention on the Rights of Persons with Disabilities: Të jetosh – Të jetosh në mënyrë të pavarur dhe të përfshihesh në komunitet Një studim ligjor mbi përdorimin aktual dhe të ardhshëm të fondëve strukturore të BE për realizimin e nenit 19 të KDPAK. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Zyra Rajonale për Europën. 2012. http://ëëë.europe.ohchr.org/documents/Publications/Getting_a_life.pdf

⁸ The right of people with disabilities to live independently and be included in the community: E drejta e personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe për t'iu përfshirë në komunitet, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Këshillit të Europës, 2011. <https://ëëë.coe.int/t/commissioner/source/prems/RightsToLiveInCommunity-GBR.pdf>

⁹ Choice and control: the right to independent living: Zgjedhja dhe kontrolli: E drejta për jetesë të pavarur, European Union Agency for Fundamental Rights (FRA), 2012. http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/2129-FRA-2012-choice-and-control_EN.pdf

për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij parimi, në rastet kur është e pashmangshme duhet të ndërtohen dhe ofrohen shërbime të veçanta për personat me aftësi të kufizuara për shkak të karakteristikave të veçanta, por nga ana tjetër, po aq e rëndësishme është që shërbimet në funksion të gjithë popullatës, të jenë të arritshme edhe për personat me aftësi të kufizuara. Këtu kujtojmë që nenet dhe parimet e konventës përshkojnë dhe zbatohen në mënyrë të ndërsjelltë me njëri tjetrin, si aksesueshmëria, mosdiskriminimi, përshtatjet e arsyeshme e të tjerë.

Cilët janë disa nga shërbimet që ofrohen për të siguruar jetesën e pavarur?

Jetesë e pavarur nuk ka në konventë një përkufizim të saktë, por mund të përcaktohet si jetesë në komunitet, e cila ka përfshirje thelbësore të personit me aftësi të kufizuara (të çdo shkalle rëndësie) në rolin e konsumatorit, i cili siguron në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo përmes një koordinimi, shërbimet e nevojshme me qëllimin për të rritur vetëvendosjen dhe për të minimizuar varësinë e panevojshme nga të tjerët. Fjala ‘konsumator’ këtu shërben për të mos humbur lidhjen mes programeve për jetesë të pavarur dhe nevojave të konsumatorit (personit me aftësi të kufizuara).¹⁰

Shërbimet përfshijnë: strehimin, kujdesin shëndetësor, lexuesit dhe / ose përkthyesit, informim dhe këshillim në lidhje me mallrat dhe shërbimet për jetesë të pavarur; transport, avokim, trajnim për aftësitë e jetesës, blerje dhe mirëmbajtjen të pajisjeve ndihmëse/teknologjike, shërbime sociale apo çlodhëse.

II. Komenti i Përgjithshëm Numër 5 (2017) Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara¹¹

Personave me aftësi të kufizuara u është mohuar historikisht zgjedhja dhe kontrolli i tyre personal dhe individual në të gjitha fushat e jetës së tyre. Shumë prej tyre janë supozuar se nuk janë në gjendje të jetojnë të pavarur në komunitetet e tyre të vetë-zgjedhur. Mbështetja ose është e padisponueshme ose e lidhur me aranzhime të veçanta të jetesës, dhe infrastruktura e komunitetit nuk është e dizajnuar në mënyrë universale. Burimet investohen në institucione në vend që të krijojnë mundësi që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur në komunitet. Kjo ka çuar në braktisje, varësi nga familja, institucionalizim, izolim dhe ndarje.

Neni 19 përfshin të drejtat civile dhe politike, si dhe ekonomike, sociale dhe kulturore dhe është një shembull i ndërlydhjes, ndërvarësisë dhe pandashmërisë së të gjitha të drejtave të njeriut. E drejta për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe për t'u përfshirë në bashkësi mund të realizohet vetëm nëse përmbushen të gjitha të drejtat ekonomike, civile, sociale dhe kulturore të përfshira në këtë normë. E drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut imponon detyrime që kanë efekt të menjëhershëm dhe të tjera që mund të realizohen në mënyrë progresive. Zbatimi i plotë gjithashtu kërkon ndryshime strukturore që mund të kenë nevojë të bëhen në faza, qoftë të drejtat civile dhe politike ose sociale, ekonomike dhe kulturore në fjalë.

¹⁰ Independent Living Models: "Modele të jetesës së pavarur", Frieden, Lex, 1980. <http://ëëë.independentliving.org/docs6/frieden1980.html>

¹¹ Informacioni në këtë seksion është marrë si ekstrakt nga Komenti i Përgjithshëm Numër 5 (2017) Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/GC/5&Lang=en

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka vërejtur përparime në zbatimin e nenit 19 në dekadën e fundit. Sidoqoftë, Komiteti vëren një hendek midis qëllimeve dhe frymës së nenit 19 dhe fushëveprimit të zbatimit të tij. Disa nga pengesat e mbetura janë këto:

- a) Heqja e zotësisë për të vepruar, qoftë përmes ligjeve dhe praktikave zyrtare, ose de-fakto, duke marrë vendime për aranzhimet e jetesës;
- (b) Papërshtatshmëria e skemave të mbështetjes sociale dhe mbrojtjes për të siguruar të jetuarit e pavarur brenda komunitetit;
- (h) Mungesa e shërbimeve dhe lehtësive të disponueshme, të pranueshme, të përballueshme, të arritshme dhe të adaptueshme, të tilla si transporti, kujdesi shëndetësor, shkollat, hapësirat publike, banesat, teatrot, kinematë, mallrat dhe shërbimet dhe ndërtesat publike;
- (i) Mungesa e mekanizmave adekuat të monitorimit për të siguruar zbatimin e duhur të nenit 19, përfshirë pjesëmarrjen e organizatave përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara;
- (j) Integrimi i pamjaftueshëm i aftësisë së kufizuar në alokimet e përgjithshme të buxhetit;
- (k) Decentralizimi i papërshtatshëm, duke rezultuar në pabarazi midis autoriteteve lokale dhe shanseve të pabarabarta për të jetuar në mënyrë të pavarur brenda komunitetit në një Shtet Palë.
- (c) Papërshtatshmëria e kornizave ligjore dhe alokimeve të buxhetit që synojnë ofrimin e ndihmës personale dhe mbështetje të individualizuar;
- (d) Institucionalizimi fizik dhe rregullator, përfshirë fëmijët dhe trajtimi i detyruar në të gjitha format e tij;
- (e) Mungesa e strategjive dhe planeve të deinstitutionalizimit dhe investimeve të vazhdueshme në mjediset e kujdesit institucional;
- (f) Qëndrimet, stigmat dhe stereotipet negative që parandalojnë personat me aftësi të kufizuara të përfshihen në komunitet dhe të kenë mundësinë e përdorimit të ndihmës në dispozicion;
- (g) Konceptet e gabuara në lidhje me të drejtën për të jetuar në mënyrë të pavarur brenda komunitetit;

Aspektet më të rëndësishme të jetesës së pavarur janë:

- a) Pavarësia si formë e autonomisë personale do të thotë që personi me aftësi të kufizuara nuk privohet nga mundësia e zgjedhjes dhe kontrollit në lidhje me stilin e jetës personale dhe aktivitetet e përditshme;
- (b) Përfshirja në komunitet. E drejta për t'u përfshirë në komunitet ka të bëjë me parimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së plotë dhe efektive në shoqëri siç është parashikuar, në mes tjerash, në nenin 3 (c) të Konventës. Parimi përfshin të jetosh një jetë të plotë shoqërore dhe të kesh akses në të gjitha shërbimet e ofruara për publikun dhe të mbështesësh shërbimet që u ofrohen personave me aftësi të kufizuara për t'i bërë të mundur që ata të përfshihen plotësisht dhe të marrin pjesë në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Këto shërbime mund të lidhen, ndër të tjera, me strehimin, transportin, blerjen, arsimin, punësimin, aktivitetet argëtuese dhe të gjitha lehtësirat dhe shërbimet e tjera të ofruara për publikun, përfshirë mediat sociale. E drejta përfshin gjithashtu hyrjen në të gjitha ngjarjet e jetës politike dhe kulturore në komunitet, ndër të tjera, takime publike, ngjarje sportive, festivale kulturore dhe fetare dhe çdo aktivitet tjetër në të cilin personi me aftësi të kufizuara dëshiron të marrë pjesë;

(c) Marrëveshjet për jetesë të pavarur. Si jetesa e pavarur ashtu edhe përfshirja në komunitet i referohen kushteve të jetës jashtë institucioneve rezidenciale të të gjitha llojeve. Nuk është "e drejtë" të jetosh në një ndërtesë ose mjedis të veçantë, për të mos humbur zgjedhjen personale dhe autonominë si rezultat i imponimit të kushteve të caktuara të jetës dhe të jetesës. As institucionet në shkallë të gjerë me më shumë se njëqind banorë dhe as shtëpi më të vogla grupi me nga pesë deri në tetë individë, madje as shtëpi individuale nuk mund të konsiderohen si jetesë e pavarur nëse ato kanë elementë të tjerë institucionalizimit.

(d) Ndihma personale. Ndihma personale i referohet mbështetjes njerëzore të drejtuar nga personi ose "përdoruesi" në dispozicion të një personi me aftësi të kufizuara dhe është një mjet për të jetuar në mënyrë të pavarur.

Detyrimet e shteteve palë:

Shtetet palë duhet të ndërmarrin hapat e mëposhtëm për të siguruar zbatimin e plotë të nenit 19 të Konventës:

(a) Shfuqizimi i të gjitha ligjeve që ndalojnë çdo person me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i dëmtimit, të zgjedhë ku dhe me kë dhe si të jetojë, duke përfshirë edhe të drejtën për të mos u kufizuar në bazë të çfarëdo lloj aftësie të kufizuar;

(b) Zbatimi i ligjeve, standardeve dhe masave të tjera me qëllim të bërjes së komuniteteve lokale dhe mjedisit, si dhe informacionit dhe komunikimit, të arritshëm për të gjithë personat me aftësi të kufizuara;

(c) Sigurimi që programet e mbrojtjes sociale plotësojnë kërkesat e një game të larmishme të personave me aftësi të kufizuara në baza të barabarta me të tjerët;

(d) Vendosja e parimit të modelit universal për hapësirën fizike dhe atë virtuale në politika, ligj, standarde dhe masa të tjera, përfshirë monitorimin e zbatimit / zbatimit të detyrimeve; rishikimi i kodeve e ndërtesave për të siguruar që ato përputhen me parimet e modelit universal dhe udhëzimeve legjislativë për ndërtimin, siç përshkruhet në komentën e përgjithshëm të Komitetit Nr. 2;

(e) Sigurimi që të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë të drejta dhe procedurale për të jetuar në mënyrë të pavarur brenda komunitetit;

(f) Informimi i personave me aftësi të kufizuara në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe të përfshihen në komunitet në mënyrë që ata të kuptojnë dhe ofrojnë trajnime fuqizuese me qëllim të mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara për të mësuar se si të zbatojnë të drejtat e tyre;

(g) Miratimi i strategjive të qarta për deinstitutionalizim, me afate specifike kohore dhe buxhete adekuate, në mënyrë që të eliminohen të gjitha format e izolimit, ndarjes dhe institucionalizimit të personave me aftësi të kufizuara; vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet personave me aftësi të kufizuara psikosociale dhe ose intelektuale dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara që ndodhen aktualisht në institucione;

(h) Krijimi i programeve të ndërgjegjësimit që trajtojnë qëndrime negative dhe stereotipe për personat me aftësi të kufizuara dhe sigurojnë transformimin e komunitetit në përpjekje për të zhvilluar shërbime të zakonshme dhe të pranueshme të rrjedhës;

(i) Sigurimi i pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara, personalisht dhe përmes organizatave të tyre përfaqësuese, në transformimin e shërbimeve mbështetëse dhe komuniteteve dhe në hartimin dhe zbatimin e strategjive të deinstitucionalizimit;

(j) Hartimi i politikave dhe udhëzimeve legjislativë gjithëpërfshirëse dhe alokimi i burimeve financiare për ndërtimin e njësisë të strehimit të përballueshëm dhe të arritshëm, mjedisin e ndërtuar, hapësirat publike dhe transportin, së bashku me një kornizë të përshtatshme kohore për zbatimin e tyre dhe sanksionet të cilat janë efektive, parandaluese dhe proporcionale për shkelje nga autoritetet publike ose private;

(k) Ndarja e burimeve për zhvillimin e shërbimeve mbështetëse të drejtuara nga personi ose "përdoruesi" të drejtuar dhe të vetë-menaxhuar për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, të tilla si ndihma personale, udhëzuesit, lexuesit dhe gjuha e shenjave të trajnuar profesionalisht ose interpretues të tjerë;

(l) Hartimi i proceseve të tenderimit për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në mënyrë të pavarur në komunitet që marrin parasysh përmbajtjen normative të nenit 19;

(m) Vendosja e mekanizmave për të monitoruar institucionet ekzistuese dhe shërbimet e banimit, strategjitë e deinstitucionalizimit dhe zbatimin e të jetuarit në mënyrë të pavarur brenda komunitetit, duke mbajtur parasysh rolin e kornizave të pavarura të monitorimit;

(n) Kryerja e monitorimit dhe zbatimit të parashikuar në nenin 19 në konsultim të plotë me dhe me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, përmes organizatave të tyre përfaqësuese.

III. Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara

Në lidhje me jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet ligji rregullon procedurat dhe kriteret e shërbimeve që do të ofrohen për të siguruar jetesën e pavarur. "Përfshirja" është një koncept shumë i gjerë dhe është një ndër sfidat më të mëdha të këtij ligji. Duke u parë përkufizimin e konceptit të përfshirjes, shohim që ai ka shtrirje në të gjithë fushat e të drejtat. Sipas Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara ajo është: pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona. Ligji vjen në përputhje të plotë me KDPAK duke vendosur theksin në liritë dhe zgjedhjet e individit, sipas nevojës. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime emundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

Jetesa e pavarur dhe përfshirja në komunitet ka të bëjë me zgjedhjet dhe mundësitë e barabarta për të jetuar në komunitet. Kjo kërkon ndër të tjera, ofrimin e shërbimeve për të realizuar zgjedhjet në kushte të barabarta me të tjerët. Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara krijon një bazë të mirë të parë për garantimin e shërbimeve të jetesës së pavarur.

Në lidhje me jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet ligji rregullon procedurat dhe kriteret e shërbimeve që do të ofrohen për të siguruar jetesën e pavarur. "Përfshirja" është një koncept shumë i gjerë dhe është një ndër sfidat më të mëdha të këtij ligji. Duke u parë përkufizimin e

konceptit të përfshirjes, shohim që ai ka shtrirje në të gjithë fushat e të drejtat. Sipas Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara ajo është: pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona. Ligji vjen në përputhje të plotë me KDPAK duke vendosur theksin në liritë dhe zgjedhjet e individit, sipas nevojës. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime emundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

Përfundime

Në lidhje me jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet, ato përbëjnë një sfidë të madhe në kushtet e Shqipërisë. Edhe pse është folur gjatë në lidhje me institucionalizimin në Shqipëri, shërbimet në komunitet janë të munguara dhe sikurse u theksua edhe më lart, jetesa e pavarur nuk është e lidhur vetëm me institucionalizimin por me shumë aspekte të tjera thelbësore të jetës së personave me aftësi të kufizuara. Zgjedhjet dhe mundësitë për të jetuar në komunitet janë dy aspekte thelbësore, të cilat lidhen drejtëpërdrejtë me ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve të jetesës së pavarur. Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë përmban përkufizimet dhe rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve, të cilat mundësojnë jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuara. Parimet e shprehura në këtë ligj qartazi garantojnë jetesën e pavarur sipas parimeve të KDPAK dhe vendosin personin me aftësi të kufizuara në qendër të vëmendjes, duke e vendosur atë në rolin e konsumatorit, me liritë dhe të drejtat për të zgjedhur se si dhe nga kush do të ofrohen këto shërbime. Megjithatë, vendimi për kriteret në lidhje me ofrimin e shërbimeve, akoma nuk është miratuar dhe pritet të miratohet në vitin 2020. Ky vendim mund të ketë një rol kryesor në realizimin efektiv të të drejtës për të jetuar në komunitet, përmes rregullimeve të aspekteve të jetesës së pavarur.